



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË MËRKURË, 16 JANAR 2019, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI

SESION I JASHTËZAKONSHËM

(Seanca filloi në orën 17:00)

Rendi i ditës:

1. Hapja e sesionit të jashtëzakonshëm të legjislaturës së IX të Kuvendit të Shqipërisë. *(neni 74, pika 3, i Kushtetutës dhe neni 42, pika 2, i Rregullores)*

2. Votimi i dekreteve të Presidentit të Republikës për shkarkim dhe emërim ministri si vijon: *(neni 98, pika 1, i Kushtetutës dhe neni 58, pika 2 e Rregullores, votim i hapur me shumicë absolute)*

- Dekret nr. 11.027, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zonjës Senida Mesi, Zëvendëskryeministre”;

- Dekret nr. 11.028, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zotit Arben Ahmetaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë”;

- Dekret nr. 11.029, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zotit Damian Gjiknuri, Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë”;

- Dekret nr. 11.030, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zonjës Lindita Nikolla, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”;

- Dekret nr. 11.031, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zonjës Mirela Kumbaro Furxhi, Ministre e Kulturës”;

- Dekret nr. 11.032, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zotit Niko Peleshi, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”;

- Dekret nr. 11.033, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zonjës Sonila Qato, Ministre e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”;

- Dekret nr. 11.034, datë 05.01.2019 “Për emërimin e zotit Erion Braçe, Zëvendëskryeministër”;

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË MËRKURË, 16 JANAR 2019

- Dekret nr. 11.036, datë 05.01.2019 “Për emërimin e zotit Eduard Shalsi, Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”;

- Dekret nr. 11.037, datë 05.01.2019 “Për një ndryshim në dekretin nr. 10.604, datë 10.09.2017 “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”;

- Dekret nr. 11.038, datë 05.01.2019 “Për emërimin e zonjës Elisa Spiropali, Ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin”;

- Dekret nr. 11039, datë 09.01.2019 “Për emërimin e zotit Bledar Çuçi, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”;

- Dekret nr. 11040, datë 09.01.2019 “Për emërimin e zonjës Belinda Balluku, Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë”;

- Dekret nr. 11041, datë 09.01.2019 “Për emërimin e zonjës Anila Denaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë”;

- Dekret nr. 11042, datë 09.01.2019 “Për emërimin e zonjës Besa Shahini, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”;

- Dekret nr. 11044, datë 09.01.2019 “Për emërimin e zonjës Elva Margariti, Ministre e Kulturës”;

Gramoz Ruçi – Të futet media brenda.

Atëherë, seancën plenare të ditës së sotme e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Në mbështetje të nenit 74, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 42, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, Kryeministri në datën 14.01.2019 ka paraqitur kërkesën për mbledhjen e Kuvendit në seancë të jashtëzakonshme.

Në mbështetje të nenit 74, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 42, Kryetari i Kuvendit jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e kërkesës thërret mbledhjen e Kuvendit mbi bazën e një rendi dite të caktuar.

Rendi i ditës është votimi i dekreteve të Presidentit të Republikës për shkarkim dhe emërim ministri, si vijon:

Dekret nr. 11027, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zonjës Senida Mesi, Zëvendëskryeministre”

Dekret nr. 11028, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zotit Arben Ahmetaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë”

Dekret nr. 11029, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zotit Damian Gjijnuri, Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë”

Dekret nr. 11030, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zonjës Lindita Nikolla, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”

Dekret nr. 11031, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zonjës Mirela Kumburo Furrxi, Ministre e Kulturës”

Dekret nr. 11032, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zotit Niko Peleshi, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”

Dekret nr. 11033, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zonjës Sonila Qato, Ministre e Shtetit për mbrojtjen e Sipërmarrjes”

Dekret nr. 11034, datë 05.01.2019 “Për emërimin e zotit Erion Braçe, Zëvendëskryeministër”

Dekret nr. 11036, datë 05.01.2019 “Për emërimin e zotit Eduard Shalsi, Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”

Dekret nr. 11037, datë 05.01.2019 “Për një ndryshim në dekretin nr.10604, datë 10.09.2017 “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”

Dekret nr. 11038, datë 05.01.2019 “Për emërimin e zonjës Elisa Spiropali, Ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin”

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË MËRKURË, 16 JANAR 2019

Dekret nr. 11039, datë 09.01.2019 “Për emërimin e zotit Bledar Çuçi, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”

Dekret nr. 11040, datë 09.01.2019 “Për emërimin e zonjës Belinda Balluku, Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë”

Dekret nr. 11041, datë 09.01.2019 “Për emërimin e zonjës Anila Denaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë”

Dekret nr. 11042, datë 09.01.2019 “Për emërimin e zonjës Besa Shahini, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”.

Dekret nr. 11044, datë 09.01.2019 “Për emërimin e zonjës Elva Margariti, Ministre e Kulturës”.

Përpara se të fillojmë votimin, ua jap fjalën dy kryetarëve të grupeve parlamentare, të cilët kanë bërë një kërkesë.

Kush e do fjalën për mënyrën e votimit?

Zoti Spaho dhe zoti Vasili.

Urdhëroni, zoti Spaho!

Edmond Spaho – Nuk kemi bërë kërkesë për mënyrën e votimit, por kemi bërë kërkesë që shqyrtimi i dekreteve për ndryshimin e qeverisë të bëhet me debat, madje kemi paraqitur listën e folësve për çdo grup parlamentar. Mbi bazën e kësaj kërkesë, kërkojmë që të zhvillohet debat, pasi mbështetemi në Rregullore dhe në Kushtetutë. Prandaj njoftoj se do të zhvillohet debat për shkarkimin dhe emërimin e ministrave.

Gramoz Ruçi – Zoti Vasili.

Petrit Vasili – Pasi kemi komunikuar edhe me stafin tuaj, i cili, ndryshe nga herët e tjera, kërkoj të depozitohej që më parë edhe zyrtarisht lista e diskutantëve, e kemi kryer këtë procedurë bazuar edhe në të gjitha mundësitë që Rregullorja na vë në dispozicion, sepse nuk ka asnjë pikë të vetme të Rregullores që të ndalojë diskutimin dhe debatin.

Në fillim, kur ju hapët seancën, po prisnim në mënyrë të natyrshme të njoftonit edhe listën e diskutantëve, ashtu sikurse e kërkon Rregullorja. Kështu që, në përputhje të procedurave, të cilat janë bërë saktësisht ashtu siç kemi komunikuar me stafin që përgatit seancën, kërkoj të di arsyet pse nuk u njoftua kjo nga ju, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Gramoz Ruçi – Zoti Balla.

Taulant Balla – Do të doja që t’u ktheja përgjigje zotit Spaho dhe zotit Vasili...

(Ndërhyrje nga zoti Spaho pa mikrofon)

Procedura parlamentare është një pro dhe një kundër.

(Ndërhyrje nga zoti Spaho pa mikrofon)

Qetësohu!

Gramoz Ruçi – Sa herë bëhet një kërkesë, është një folës pro dhe një kundër.

(Ndërhyrje nga zoti Spaho pa mikrofon)

Ju lutem, është Rregullorja e Kuvendit!

(Ndërhyrje nga zoti Spaho pa mikrofon)

Taulant Balla – Zoti Spaho, qetësohu!

(Ndërhyrje nga zoti Spaho pa mikrofon)

Zoti Spaho, qetësohu! Qetësohu! Në 27 vjet parlament, kur dikush ka ngritur një shqetësim për procedurë, ka pasur një diskutim pro dhe një diskutim kundër. Tani dëgjoni edhe mendimin tonë dhe, sigurisht, është Kryetari i Kuvendit ai që vendos.

Së pari, duhet ta themi shumë qartë që, kur çohet dikush këtu, duhet të paktën të citojë një nen të Rregullores. Thoni nenin e Rregullores që i referohet shkarkimit dhe emërimit të ministrave, gjejeni dhe...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Të lutem, 2 sekonda!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ne shkollëpakët, ti shkollëshumi!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ta mbarojmë ne shkollëpakët dhe fillo ti shkollëshumi...

Gramoz Ruçi – Të lutem!

Taulant Balla – Në Rregulloren e Kuvendit ka nen për emërimin dhe shkarkimin e Presidentit të Republikës, ka nen për emërimin dhe shkarkimin e qeverisë, ku bëhet fjalë për mocion mosbesimi, ka nen për titullarët e institucioneve, qofshin ato kushtetuese apo të caktuara me ligj. Me këtë Rregullore që kemi dhe në kaq vite, ku pjesa më e madhe janë me katër apo më shumë mandate...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Unë jam me katër mandate në këtë Kuvend, asnjëherë nuk kemi bërë debat për emërimin apo për shkarkimin.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

I heqim të gjitha këto.

Zotërinj, jeni njoftuar edhe dje, ju të dy keni qenë me ne, për urdhrin e thirrjes së seancës. I keni pasur të gjitha mundësitë. Në këtë urdhr për thirrjen e seancës, i cili e ka caktuar seancën në zbatim të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit, është përcaktuar (së

pari, që ta dini, ju lutem, mos bëni shumë lapsuse, kjo nuk është seancë e jashtëzakonshme) se ky është sesion i jashtëzakonshëm, kështu thuhet në Kushtetutë. Në bazë të nenit për thirrjen e sesionit të jashtëzakonshëm nga ana e Kryeministrit, Kryeministri i është drejtuar Kuvendit, sepse tri janë autoritetet që mund t'i drejtohen Kuvendit për thirrjen e sesionit të jashtëzakonshëm: Presidenti i Republikës, Kryeministri ose 1/5-ta e deputetëve.

Në bazë të nenit të Kushtetutës për sesionin e jashtëzakonshëm, Kryeministri ka kërkuar votimin e dekreteve për shkarkim dhe për emërim dhe autoriteti i vetëm, Kryetari i Kuvendit, ka nxjerrë urdhrin për thirrjen e seancës me këtë rend dite: votim i dekreteve të Presidentit të Republikës.

Debatin mund ta bëni kur të doni dhe si të doni, por duke zbatuar Rregulloren. Bëni kërkesën: mocion me debat me qeverinë! Po të keni forcë, bujrrëm, bëni edhe mocion mosbesimi ndaj qeverisë, por ne nuk kemi kohë për të humbur me ju për llogje pazari sa herë t'ju teket dhe kur të doni; nuk jua plotësojmë dot këtë dëshirë.

Qoftë edhe një nen të vetëm të Rregullores së Kuvendit të kishit cituar për atë që thoni...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Del zoti Spaho këtu dhe thotë: "Në bazë të Rregullores së Kuvendit".

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Po ku është neni i Rregullores së Kuvendit?!

Del ai tjetri dhe thotë: "Në bazë të Kushtetutës". Në bazë të Kushtetutës është e përcaktuar.

Është hera e fundit që jua them: sa herë ju kam thënë këtu, hajdeni, bujrrëm, të ulemi...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Të lutem, tani, më lër të flas!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Pusho!

Gramoz Ruçi – Zoti Balla, ju mbaroi koha!

Taulant Balla – Hajde ulemi të rishohim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Mediu – Më vjen keq që ky sesion parlamentar nisi kështu, që duartrokisni kryetarin e grupit kur thotë se parlamenti bën vetëm llogje. Në qoftë se e konsideroni veten pjesë të llogjeve, vazhdoni dhe duartrokisni!

Meqenëse doni t'ju citoj nenin, lexoni nenin 48 të Rregullores, i cili thotë: "Çdo diskutues, me përjashtim të rasteve kur në këtë Rregullore përcaktohet ndryshe, ka të drejtë të flasë jo më shumë se 10 minuta. Diskutuesi nuk mund të flasë më shumë se një herë". Pika 2 e nenit thotë: "Koha e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dyfishohet kur diskutohet programi politik dhe përbërja e Këshillit të Ministrave". Sot në rendin e ditës kemi përbërjen e Këshillit të Ministrave dhe koha e debatit duhet të dyfishohet. Nuk ka asnjë nen që e ndalon debatin. Përveç asaj, debati për ndryshimin e qeverisë tashmë është një debat publik. Ju doni të ndaloni Kuvendin e Shqipërisë për të bërë një debat rreth Këshillit të Ministrave dhe riorganizimit të tij. Vetëm në një republikë bananesh ndodh kjo. Nuk e di se çfarë të keqe ka nga një debat, i cili do të zhvillohet nga të dyja palët për të gjykuar atë që është e mirë apo e keqe. Nëse jemi parlamentarë, jemi këtu si të tillë dhe nuk jemi si mbështetës dhe zëdhënës të qeverisë.

Gramoz Ruçi – Në përgjigje të pretendimeve që u ngritën dhe në respekt të dy kërkesave të të dyja grupeve parlamentare, më lejoni t'ju them se gjatë ditës së sotme shërbimet e Kuvendit, jo të miat, janë konsultuar me Rregulloren e Kuvendit për rastet kur dekretet e Presidentit vijnë për t'u votuar në Kuvend dhe në asnjë nen të Rregullores nuk thuhet se dekretet e Presidentit për emërimet dhe çemërimet bëhen me debat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqenëse nuk e gjetën aty, u kërkova shërbimeve të Kuvendit precedentët parlamentarë dhe më nxorën se që nga viti 1999-2018 janë zhvilluar 37 seanca plenare për emërimet dhe shkarkime ministrash, konkretisht në: 1999-ën, 3 dekrete; në 2000-in, 23 dekrete; 2001-in, 2 dekrete; në 2003-in, 26 dekrete; në 2007-ën, 17 dekrete; në 2008-ën, 10 dekrete; në 2009-ën, 4 dekrete; në 2010-ën, 9 dekrete; në 2011-ën, 10 dekrete; në 2012-ën, 8 dekrete; në 2013-ën, 9 dekrete; në 2014-ën, 2 dekrete; në 2015-ën, 7 dekrete; në 2016-ën, 7 dekrete; në 2017-ën, 23 dekrete dhe në 2018-ën, 2 dekrete. Gjithsej 162 dekrete.

Pra, 37 seanca dhe 162 dekrete emërimesh dhe shkarkimesh, edhe pse është kërkuar si sot, përsëri janë zhvilluar pa debate.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË MËRKURË, 16 JANAR 2019

(Opozita largohet nga salla.)
(Zoti Berisha del në foltore dhe flet pa mikrofon.)

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

Janë të pranishëm 76 deputetë.

Fillojmë votimin për dekretin nr. 11027, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zonjës Senida Mesi, Zëvendëskryeministre”.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

76 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet.

Dekret nr. 11028, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zotit Arben Ahmetaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë”.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

77 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet.

Dekreti nr. 11029, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zotit Damian Gjijnuri, Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë”.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

76 vota pro.

Miratohet.

Dekreti nr. 11030, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zonjës Lindita Nikolla, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

77 vota pro.

Miratohet.

Dekret për shkarkimin e zonjës Mirela Kumbaro Furxhi, Ministre e Kulturës.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

76 vota pro.

Dekret nr. 11032, datë 05.01.2019 “Për shkarkimin e zotit Niko Peleshi, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

77 vota pro.

Miratohet.

Dekret për shkarkimin e zonjës Sonila Qato, Ministre e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

77 vota pro.

Miratohet.

Dekret për emërimin e zotit Erion Braçe, Zëvendëskryeministër.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

77 vota pro.

Miratohet.

Dekret për emërimin e zotit Eduard Shalsi, Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

77 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Dekret për ndryshim të dekretit nr. 10604, datë 10.09.2017 “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

77 vota pro.

Miratohet.

Dekret për emërimin e zonjës Elisa Spiropali, Ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

77 vota pro.

Miratohet.

Dekret për emërimin e zotit Bledar Çuçi, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

77 vota pro.

Miratohet.

Dekret për emërimin e zonjës Belinda Balluku, Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

77 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Dekret për emërimin e zonjës Anila Dena, Ministre e Financave dhe Ekonomisë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

77 vota pro.

Miratohet.

Dekret për emërimin e zonjës Besa Shahini, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË MËRKURË, 16 JANAR 2019

Hapet votimi.
Mbyllet votimi.
77 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.
Miratohet.
Dekret për emërimin e zonjës Elva
Margariti, Ministre e Kulturës.
Hapet votimi.
Mbyllet votimi.
77 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.
Këtu mbyllet miratimi i dekreteve për
emërimin dhe shkarkimin e ministrave.
Seanca tjetër, ku do të hapet sesioni i ri
parlamentar, do të njoftohet.
Faleminderit!

(Seanca u mbyll në orën 17:40)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**

